



**POLICY
ANSWERS**

SHKURTIMISHT PËR: STRATEGJINË E ENERGJISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS 2022-2031

Responsible organisation: Riinvest
Institute

Date: November 2022



<https://www.facebook.com/WBInfoHub>



<https://x.com/wbinfohub>



<https://www.linkedin.com/company/wbinfohub/>

www.westernbalkans-infohub.eu

POLICY ANSWERS is funded by the European Commission through the Horizon Europe project "R&I POLICY making, implementation AND Support in the WEsteRn BalkanS", Grant Agreement N° 10105887.



**Funded by
the European Union**

HYRJE*

Sektori energjetik, në mënyrë të veçantë ai i prodhimit të energjisë elektrike, vijon të mbetet një ndër sektorët më problematik në Kosovë. Konsumatorët përballen me furnizim jocilësor dhe jo stabil të energjisë elektrike, e cila është shndërruar në barrierë për zhvillimin ekonomik të vendit. Si pasojë e trajtimit jo të duhur të këtij sektori për më shumë se dy dekada, Kosova vijon të ketë varësi të lartë nga importi i paplanifikuar i energjisë elektrike. Në rrethanat kur një pjesë e kapaciteteve aktuale gjeneruese janë në limitet e tyre të operimit për shkak të amortizimit të madh teknologjik e kohorë, çështja e trajtimit të energjisë bëhet edhe më urgjente. Megjithatë, një urgjencë e tillë në asnjë mënyrë nuk duhet të jetë pengesë që zgjidhjet e propozuara të kalojnë nëpër një filtër i cili peshon në mënyrë cilësore kostot dhe përfitimet në prizmin e zgjedhjeve alternative.

Në të njëjtën kohë me krizën globale të furnizimit me energji, krizë kjo e cila po manifestohet me tërë ashpërsinë e saj edhe në Kosovë, po diskutohet edhe Strategjia e zhvillimit të këtij sektori për periudhën 2022-2031. Rrjedhimisht ky draft i Strategjisë është dizajnuar që të aplikoj një qasje të re përmes investimeve në kapacitetet prodhuese aktuale, transformimit drejt burimeve të ripërtëritshme të energjisë, si dhe integritimit më të lartë të sektorit energjetik të Kosovës në tregun rajonal dhe në atë ndërkombëtar për të përballuar nevojat në rritje të konsumit. Në këtë kontekst ky dokument ka zgjuar interesim jo vetëm tek ekspertët e energjisë, shoqëria civile, forcat politike por edhe tek opinioni i gjerë dhe është përcjellë edhe me debate kundërshtuese. Andaj mbetet ende për t'u dëshiruar një nivel më i lartë konsensusi nacional për këtë dokument të rëndësishëm. Instituti Riinvest ka përcjellë këto diskutime dhe me 4 nëntor të vitit 2022 organizoi një diskutim në panel rreth këtij dokumenti në kuadër të debateve 'Green Talks' si pjesë e platformës [Green Action Space](#) të lansuar në bashkëpunim me Fondacionin e Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS). Kjo analizë e shkurtër synon të skicojë shkurtimisht çështjet kryesore që burojnë nga ky diskutim dhe debatet e tjera në shoqëri, si dhe të ofrojë disa rekomandime e sugjerime lidhur me këtë dokument.

SITUATA E PËRGJITHSHME E SEKTORIT ENERGETIK NË KOSOVË

Sektori energjetik në Kosovë i bazuar kryesisht në burimet e energjisë fosile – pra atë të thëngjillit, ballafaqohet me probleme të rënda për përballimin e nevojave të konsumatorëve. Aktualisht, mbi 80 përqind e nevojave sigurohen nga termocentralet Kosova A (të ndërtuara në vitet 60-të) dhe Kosova B (të ndërtuara në vitet 80-të), të cilat janë në fund të jetëgjatësisë së tyre teknike. Kjo rezulton në shpeshtësi të ndërprerjeve të paplanifikuara. Të dyja termocentralet duhet të rinovohen për të përmbushur edhe standardet e kërkuara të emetimeve.

Kapaciteti i instaluar nga burimet e rinovueshme është modest, megjithatë ka pasur një rritje të tyre gjatë viteve të fundit. Deri në vitin 2021, kapacitete prej 137 MW të njësive të gjenerimit të erës janë vënë në punë në Kosovë, duke rezultuar në një pjesëmarrje të erës prej 9 përqind të kapacitetit

* Publikuar nga Instituti Riinvest. Ky dokument është nxjerrë nga seria e debateve 'Green Talks' në kuadër të platformës Green Action Space, iniciativë e përbashkët e Institutit Riinvest dhe fondacionit të Kosovës për Shoqëri të Hapur (KFOS). Përmbajtja e këtij publikimi janë përgjegjësi e Institutit Riinvest.

të instaluar. Edhe hidro-energji është element i rëndësishëm i sistemit elektroenergjetik me pjesëmarrje prej 6.5 përqind të kapacitetit total të instaluar.

Konsumi i energjisë elektrike ka vijuar të rritet gjatë viteve të fundit. Konsumi i energjisë primare është rritur me një mesatare vjetore prej 1.4% midis viteve 2008 dhe 2020. Pjesëmarrjen më të madhe në konsumin final të energjisë e kanë amvisëritë (40% në vitin 2020). Konsumi i energjisë nga kjo kategori është ngushtë i lidhur edhe me sektorin e ngrohjes, ku përgjatë stinës së dimrit kërkesat për energji rriten në mënyrë eksponenciale. Për pasojë, prodhimi nga kapacitetet vendore në këtë periudhë nuk mbulon kërkesën, e cila më pas duhet të mbulohet nga importi. Kjo çështje është veçanërisht problematike në kushtet kur çmimet e energjisë elektrike janë rritur ndjeshëm.

Në përgjithësi zhvillimi i këtij sektori ka pasur ngecje me investimet për pothuajse katër dekada, ndërsa intervenimet e pasluftës kanë qenë më shumë nën presion të mbajtjes së funksionalitetit të termocentraleve të tejvjetruara, të menaxhuara dhe mirëmbajtura jo mirë, se sa për të adresuar sfidat zhvillimore. Prandaj tranzicioni i imponuar përmes Agjendës së Gjellbër e gjen Kosovën mjaft të papërgatitur dhe me probleme serioze për të përballuar kërkesat nga sistemi energjetik në një anën dhe kërkesat për furnizim të konsumatorëve në anën tjetër. Një rrethanë pozitive është se Kosova ka interkoneksion të mirë me rrjetet rajonale energjetike, dhe vlerësohet të jetë ndër më të fortit në Evropë. Për rrjedhojë, thellimi i bashkëpunimit me fqinjët, veçanërisht me Shqipërinë, është qenësor për të siguruar funksionimin efikas dhe të bazuar në treg të këtyre interkoneksioneve.

Sfidat e kryesore të sektorit energjetik, mes tjerash, vlerësohen të jenë: vjetërsia e kapaciteteve prodhuese energjetike dhe mungesa e fleksibilitetit për të akomoduar burimet e rinovueshme, brishtësia për shkak të varësisë prej importeve nga tregu i jashtëm, intensitet të lartë të energjisë, rritja e presionit nga kërkesa vendore në rritje, dhe ndotja e ambientit. Përtej këtyre sfidave, kryesisht të brendshme, sektori energjetik ballafaqohet edhe me sfida të jashtme të lidhura me luhatjet e mëdha të çmimeve të energjisë në tregjet ndërkombëtare si pasojë e zhvillimeve më të gjera gjeopolitike siç është COVID19 dhe invazioni rus në Ukrainë. Të njëjtat krijojnë një presion shumë të madh ndaj buxhetit të shtetit për të subvencionuar importin e energjisë në përpjekje për të mbajtur çmimet për konsumatorë në nivele të përballueshme.

PIKËPAMJET MBI DRAFT-STRATEGJINË E ENERGJISË NË KOSOVË 2022-2031

Pikëpamjet e paraqitura rreth draft-strategjisë e që u theksuan edhe nga penalistët në diskutimin në Institutin Riinvest nisen nga konteksti në të cilën kjo strategji po diskutohet, e sidomos nga kërkesat e përkushtimit të Kosovës për Agjendën e Gjellbër për Ballkanin Perëndimor dhe zhvillimeve të fundit gjeopolitike

Draft strategjia ka një vizion ambicioz për sektorin e energjisë dhe është formuluar si në vijim “Një sektor energjetik pa CO₂ deri në vitin 2050, i integruar në tregun Pan-Evropian, duke garantuar siguri të furnizimit me energji elektrike dhe përballueshmëri për qytetarët”. Bazuar në këtë vizion dhe në analizat e bëra për sektorin e energjisë, janë përcaktuar qëllimet kryesore dhe objektivat strategjike (drejtimet kryesore të politikave) që sigurojnë arritjen e këtij vizioni. Në thelb të draft-strategjisë paraqitet të jetë: (a) rritja e sigurisë së furnizimit (mes tjerash përmes, rritjes së fleksibilitetit të sistemit; rritjes së efikasësisë së energjisë për të zvogëluar kërkesën; promovimit të energjisë së rinovueshme; forcimit të bashkëpunimit rajonal); (b) arritja e qëndrueshmërisë dhe

neutralitetit klimatik (mes tjerash përmes, rritjes së efikasitetit të energjisë për të ulur konsumin e energjisë; dekarbonizimit dhe promovimit të energjisë së rinovueshme; kufizimit të ndikimit negativ të sektorit të energjisë në shëndetin e njeriut dhe mjedisin); (c) përmirësimi i konkurrueshmërisë (mes tjerash përmes, fuqizimit të bashkëpunimit rajonal dhe funksionimit të tregut; krijimit të stimulave për kursim të energjisë) dhe (d) ruajtja e përballueshmërisë (mes tjerash përmes, rritjes së efikasitetit; promovimit të vetëkonsumit; uljes së çmimeve si rezultat i rritjes së konkurrueshmërisë së tregut; mbrojtjes së konsumatorëve në nevojë; rritjes së shkathtësisë të fuqisë punëtore të këtij sektori).

Sipas pikëpamjes së qeverisë, arritja e këtyre qëllimeve është e mundshme edhe falë zhvillimeve shumë të shpejta teknologjike në këtë sektor. Për më tepër, sipas qeverisë, kjo strategji hapë dyert për investorët privat për shkak se e njëjta krijon parashikueshmëri ligjore e rregullatore.

Në anën tjetër Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC) kanë shprehur vlerësimet dhe kritikën e tyre mbi draft-strategjinë. Në përgjithësi OSHC-të kanë vlerësuar pozitivisht dhe mirëpritur këtë draft-strategji, si njëri ndër hapat e parë dhe konkret drejt adresimit të çështjes energjetike në Kosovë, sidomos lidhur me ambicet e saj për të rritur gjenerimin e energjisë nga burime të ripërtëritshme nga 6% sa është tani në 32% të prodhimit të tërësishëm në vitin 2031. OSHC-të kanë kritikuar përfshirjen e vogël të tyre në grupet punuese gjatë hartimit të strategjisë. Megjithatë, është përshëndetur orientimi i qartë i draft-strategjisë për të promovuar energjinë nga burimet e rinovueshme.

Gjithashtu sektori privat ka vlerësuar pozitivisht hapat e ndërmarrë nga qeveria drejt largimit të varësisë tejet të madhe energjetike nga burimet e linjtit. Në mënyrë specifike, është vlerësuar si pozitive krijimi i një perspektive më të qartë se në të kaluarën. Megjithatë sektori privat ka adresuar dy pika kryesore në të cilat do të nevojitet vëmendja e duhur e qeverisë: krijimi i investimeve të duhura në infrastrukturën energjetike, dhe intervenimi shtetëror në kostot e kredive investuese në këtë sektor.

Dilema jo të vogla dhe kritika ka zgjuar mos inkuadrimi i investimeve në gazifikim, e që Kosovën e bën të veçohet nga tërë rajoni por edhe më gjerë në këtë aspekt. Draft-strategjia parasheh instalimin e kapaciteteve akumuluese të energjisë përmes baterive. Kjo do të ndihmojë në përmirësimin e fleksibilitetit të sistemit dhe integrimin e burimeve të rinovueshme variable, por gjithashtu do të jetë i nevojshëm për të përmbushur kërkesat e ENTSO-E për rezervë të energjisë, dhe në një masë do të ndihmojë në uljen e importit të energjisë elektrike.

REKOMANDIME RRETH DRAFT-STRATEGJISË MBI ENERGJINË NË KOSOVË 2022-2031

Në vijim janë paraqitur disa nga sugjerimet dhe rekomandimet e Institutit Riinvest që burojnë nga vlerësimi i draft-strategjisë së energjinë në Kosovë 2022-2031:

- Strategjia e energjisë në versionin final duhet të përfshijë edhe dy sektorë të rëndësishëm që përfaqësojnë ndër grupet më të mëdha që konsumojnë energji: (i) sektorin e transportit dhe (ii) sektorin e industrisë dhe atë komercial. Sipas draft-strategjisë, masat për adresimin e objektivave që lidhen me këta sektorë do të shqyrtohen në Strategjinë e Transportit dhe Strategjinë e Industrisë. Mos trajtimi i këtyre sektorëve është një handikap i kësaj strategjie.

- Draft-strategjia e energjisë duhet të trajtoj me kujdes opsionet për ndërtimin e një sistemi me bazë gazi natyror në Kosovë. Një analizë e tillë, sipas draft-strategjisë, është duke u bërë në Master Planin e Gazit dhe në studimin e fizibilitetit për tubacionin e interkoneksionit të gazit në mes të Maqedonisë së Veriut dhe Kosovës, megjithatë e njëjta duhet të reflektohet në strategji. Gjithashtu, draft-strategjia duhet të përbrendësoj mundësinë e gazifikimit të linjtit në Kosovë.
- Draft-strategjia e energjisë duhet të trajtoj në mënyrë më të detajuar mundësitë e (bashkë)investimit në kapacitetet gjeneruese të energjisë elektrike në vendet e rajonit, posaçërisht në burime ujore në Shqipëri. Strategjia evidenton që Kosova ka edhe opsionin e shfrytëzimit të infrastrukturës së gazit që është planifikuar në Shqipëri (lidhja në TAP ose qasja në terminalin e LNG në Vlorë), dhe që infrastruktura e gazit në rajon dhe në Greqi ofron mundësi për (bashkë)investim në kapacitetet gjeneruese të energjisë elektrike. Megjithatë, kjo duhet të detajohet edhe më tej.
- Duke marrë parasysh efektet pozitive mjedisore siç janë reduktimet e emetimit të ndotësve në atmosferë dhe reduktimit të humbjeve të energjisë nëpër shpërndarje, vlerësohet si i nevojshëm që përshtetimi dhe zgjerimi i projektit të ngrohjes me kogjenerim në kryeqytet por edhe në qendrat e tjera urbane. Kjo nevojë duhet të trajtohet me prioritet.
- Duke marrë parasysh stoqet e mëdha të linjtit në Kosovë, strategjia gjithsesi duhet të përmbajë një obligim për institucionet, sektorin e energjisë, qarqet akademike dhe shkencore, lidhur me politikat dhe strategjinë afatgjatë të valorizimit të këtij resursi të madh natyror në harmoni me zhvillimet teknologjike, shkencore dhe kërkesat e mbrojtjes mjedisore, që po adresojnë shfrytëzimin e linjtit në gjenerimin e energjisë nëpërmjet procesit të lëngëzimit të thëngjillit ose edhe për procese të tjera të kimizimit të tij.
- Strategjia duhet të përmbajë një obligim për institucionet që të parashihen hapat e krimit të një regjistri gjithëpërfshirës të konsumatorëve në nevojë në mënyrë që subvencioni i ofruar nga Qeveria e Kosovës të targetohet tek këto kategori për të ulur ndikimin e rritjes së tarifave e jo të aplikohet si subvencion indirekt për të gjithë konsumatorët përmes tarifave të energjisë elektrike.
- Duhet të merren në konsideratë projektimet e ardhshme të konsumit të energjisë, përmes integritetit të bilanceve të konsumit. Integrimi i bilanceve të konsumit duhet të përfshijë amvisërinë, industrinë por edhe shërbimet e tjera. Përmes posedimit të një pasqyre të qartë të konsumit të ardhshëm energjetik do të ishte më e saktë edhe përshtatja dhe planifikimi i kapaciteteve energjetike.